

Sot më datë 15 Mars 2017, me Vendimin Nr. 43, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, vendosi Certifikimin final të Operatorit të Sistemit të Transmetimit – OST sh.a. në përputhje me përcaktimet e Nenit 58 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Vendimi i sotëm pason Aplikimin për Certifikim të datës 13 Korrik 2016, të paraqitur nga shoqëria Operatori i Sistemit të Transmetimit – OST sh.a. pranë Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me certifikimin e ndarjes së shoqërisë OST sh.a., nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike në përputhje me përcaktimet e neneve 54 dhe 58 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Me herët me Vendimin e Bordit Nr. 165, datë 06 Tetor 2016, Enti Rregullator i Energjisë kishte miratuar Certifikimin Paraprak të shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit-OST sh.a. me konkluzionin se OST sh.a. përmbush të gjitha detyrimet e parashikuara në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i cili transponon dispozitat e Direktivës 2009/72/KE dhe Rregullores (KE) Nr. 714/2009.

Ndërkohë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë , është shprehur pozitivisht nëpërmjet opinionit nr. 1/17, datë 23 Janar 2017, në përputhje me nenin 3(1) të Rregullores (KE) Nr. 714/2009 dhe nenit 10(6) të Direktivës 2009/72/KE mbi Certifikimin e OST sh.a., Shqipëri, në lidhje me aplikimin e paraqitur nga OST sh.a., dokumentacionin mbështetës dhe vendimin paraprak të ERE duke kërkuar të vendosë kërkesa të tjera për kompaninë OST (brenda një afati kohor jo më tepër se 12 muaj) që kanë të bëjnë me:

- zbatimin e programit të pajtueshmërisë dhe emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë ;
- ofrimin e të dhënave që Ministria e Energjisë nuk mund të propozojë miratimin (ose kundërshtimin) tek Këshilli i Ministrave të interkonjektorëve të rinj që do të ndërtohen nga OST, në bazë të legjislacionit përkatës primar ose sekondar;
- ofrimin e provave që Ministria e Ekonomisë ka autoritetin ekskluziv për të dhënë opinione në ERE për planin e zhvillimit të rrjetit, në bazë të legjislacionit përkatës primar ose sekondar.

Vendimi i sotëm shënon një moment shumë të rëndësishëm për OST sh.a në drejtim të implementimit të ligji nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.